



### **Koha për zëra të rinj konstruktiv**

Pas një tubimi në Gračanica/Graçanicë, një grup divers i organizatave të shoqërisë civile nga Kosova dhe Serbia kanë miratuar deklaratën e përbashkët vijuese duke bërë thirrje për zëra të rinj konstruktivë - zëra që shikojnë nga e ardhmja duke mbajtur një sy të mprehtë në të kaluarën; zëra që kërkojnë partneritete dhe koalicione përtej vijave të kuqe që supozohet t'i definojë ato; dhe zëra që ngrihen publikisht kundër retorikës përçarëse dhe poshtëruese.

---

Cikli i vazhdueshëm i përshkallëzimit dhe de-eskalimit në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë paraqet dështim të imagjinatës politike.

Energjia që shpenzohet në përballje me krizën e fundit shpërqendron nga tërësia e çështjeve urgjente që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve në Serbi dhe Kosovë.

Trendi tashmë ekzistues është që njerëzit veç se po largohen nga Serbia dhe Kosova, veçanërisht të rinjtë. Ndërsa ngrihen barrkada të reja, aq dhe valixhe të reja mbushen. Shumë pak prej tyre ka të gjasë të kthehen. E ardhmja e vendeve tona do të jetohet diku tjetër.

Shumë grupe që konsiderohen jashtë spektrit të dialogut Beograd-Prishtinë janë në themel të injoruar. Komuniteti rom, nëse marrim njërin, e sheh veten të marginalizuar si në Serbi ashtu edhe në Kosovë.

Me perspektivën e dhunshme që është më e theksuar se sa ka qenë për një dekadë, është koha tani që të dëgjohen zëra të rinj konstruktiv – zëra që shikojnë nga e ardhmja duke mbajtur shikimin e mprehtë nga e kaluara; zëra që kërkojnë partneritete dhe koalicione përtej vijave të kuqe që

supozohet të na përcaktojnë; zëra që ngrihen publikisht kundër retorikës përçarëse dhe poshtëruese.

Ne, të nënshkruarit, marrim përsipër të mbajmë kanale komunikimi që zvogëlojnë mundësitë për keqkuptim dhe dezinformim. Shumë shpesh ne kemi folur pa e kuptuar njëri-tjetrin, duke këmbëngulur në rëndësinë e një pike, ndërkohë duke e nënvlerësuar apo injoruar plotësisht ekzistencën e një tjetre.

Mendojmë se i kuptojmë detajet e një çështjeje, por nuk arrimë të marrim parasysh se si kuptohet apo shihet ajo nga komunitetet e tjera. Të gjithë duhet të jemi të përkushtuar të dëgjojmë me veshë të hapur dhe mendje të hapur.

Vetëm duke ndarë perspektivat dhe perceptimet nga komunitetet tona përkatëse mund të fillojmë të ecim drejt një rruge të përbashkët për të ardhmen. Shumë nga problemet me të cilat përballen komunitetet tona përkatëse janë pothuajse identike, megjithatë ne rrallë e pranojmë këtë fakt.

Nëse ka pasur ndonjëherë një kohë për solidaritet në dekadën e fundit, është kjo tani. Lufta në Ukrainë është përkujtim i dhimbshëm i realiteteve të zymta të luftës, edhe pse trashëgimitë tona mbeten të afërta.

Kauza e paqes nuk kërkon vetëm fjalë për këtë qëllim, por imazhe e marrëdhënie që mishërojnë të qenit bashkë. Qëndrojmë kundërshtues ndaj të gjitha projeksioneve të panevojshme të forcës dhe të gjithë narrativave të urrejtjes e përçarjes.

E ardhmja e Kosovës dhe e Serbisë janë të lidhura në mënyrë të pashmangshme me njëra-tjetrën dhe një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve është hap i parë jetik në ndërtimin e një të nesërme më të mirë. Por është vetëm një hap i parë.

#### **Nënshkrues:**

1. AKTIV
2. Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC)
3. The Balkan Forum
4. Belgrade Centre for Security Policy (BCSP)
5. Community Building Mitrovica (CBM)
6. Center for Peace and Tolerance (CPT)
7. Civic Initiatives, Serbi
8. Centre for Interdisciplinary Studies of the Balkans, Beograd
9. European Fund for the Balkans
10. Forum for Development and Multiethnic Collaboration (FDMC)
11. Foundation BFPE for a Responsible Society (BFPE)
12. Gorazdevac Media Group
13. Institute for Territorial Economic Development – InTER
14. Jelena Loncar, Akademike nga Universiteti i Beogradit
15. Local Peace, Leposaviq
16. Lawyers' Committee for Human Rights (YUCOM)
17. Milan Antonijević, Avokat, Serbi
18. New Perspektiva
19. New Social Initiative (NSI)
20. NGO Integra
21. NGO Be Active 16, Preshevë
22. NGO Livrit, Preshevë
23. Peer Educators Network (PEN)
24. Rahim Salihi, aktivist i shoqërisë civile, Bujanoc
25. Radio Peja

26. Radio Astra, Prizren
27. RTV KIM
28. TV Prizreni, Prizren
29. Voice of Roma, Ashkali and Egyptians in Kosovo (VoRAE)
30. Youth Initiative for Human Rights - Kosovë
31. Youth Initiative for Human Rights – Serbi
32. Valon Arifi, aktivist i shoqërisë civile, Bujanoc
33. Vjollca Krasniqi, Akademike nga Universiteti i Prishtinës
34. Qendra për Demokraci dhe Edukim – Lugina
35. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)